



Dalës-Izlazna

Nr. 1-118  
Br.

Data 20.09.2021  
Datum



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

## E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.31.08.2021, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Burim Gërguri (AAK), Enver Gashi (AAK), Florije Jashari (AAK), Qendresa Dubova (AAK), Lulzim Bllaca (AAK), Labinot Mirena, (AAK), Shaip Paloja (LDK), Fatos Kurshumlija (LDK), Arbmore Nasufi (LDK), Fatmir Bekteshi (LDK), Linda Sadiku (LDK), Lulzim Sadiku (PDK), Hysni Mjeku (PDK), Samire Berisha (PDK), Aziz Bici (LVV), Xhezide Dragusha, (LVV), Armend Rushiti (LB), Nora Preniqi, (LB), Namzi Gashi (Nisma), Slavisa Spasic (SL) dhe Dragan Dancetovic (SL).

**Të pranishmit tjerë:** Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, drejtorët komunal dhe përf. i IZHL-së  
Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal, i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

### R E N D I T E

1. Arsyetimi për munges
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin financiar 2020 dhe plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga ZKA, për Komunën e Obiliqit për vitin 2020
4. Shqyrtimi i raportit financiar Janar – Qershor, 2021 të Kryetarit të Komunës
5. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së
6. Shqyrtimi i raportit të DKA-së
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme

**Kryesuesi** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.  
Miratohet njëzërit rendi i ditës i cekur më lartë.

#### **Pika 1 rendit të ditës**

Të gjithë anëtarët e Kuvendit ishin të pranishëm në mbledhje.

#### **Pika 2 e rendit të ditës**

Miratohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje

#### **Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Ju njoftoj se Raporti i Zyres Kombëtare të Auditimit na ka ardhë me dt.15.07.2021. Ne në mbledhjen e KPF-së, e kemi trajtuar këtë raport dhe kemi konstatuar se raporti është shumë më i mirë se në vitin e kaluar pa theksim të çështjeve. Mbi të gjitha raporti i auditorit është një raport i pakualifikuar.

**Lulzim Sadiku** – Unë do ta japë një mendim të cilin e kam marrë nga raporti i auditimit. Në këtë raport ka shumë shkelje të evidentuara dhe unë do ti përmendi disa prej tyre. Nga 7 rekomandime mbi dobësitë e gjetura në Komunë për vitin 2019, vetëm një rekomandim është i zbatuar, 5 nuk janë zbatuar dhe një është i mbyllur.. Për vitin 2020, janë të evidentuara nga auditori edhe 11 të gjetura, apo dobësi që është shqetësuese dhe në vend që të zvoglohen, apo eliminohen në tërësi dobësitë e shprehura në rekomandime, ato vetëm po rriten nga 5 të mbetura nga viti 2019, me këto. Në vitin 2020, janë bërë gjithsejt 16. Rekomandimet që janë

në esencë dobësi për shkelje të Komunës, Komuna ka manifestuar shumë lëshime gjatë vitit 2020, që janë evidentuar nga raporti i auditorit, ose të mbledhura në pagesa të avanseve të firmave, pa krye punë në përqindje të palejuar vetëm e vetëm për ta shmangur suficitin, që është veprim antiligjor. Ekzekutimi i projekteve pa hartim paraprak të projekteve zbatuese janë 9 nga zyra e Prokurimit, që i ka procedue pa pasë fare projekt zbatues dhe kjo është punë në kundërshtim të plotë me ligjin. Po ashtu, ka manevrime të mëdha të tenderi mirëmbajtja e parqeve, si te kontrata 3 vjeçare ku vërehet pagesa e pozicioneve edhe nga 2 herë për të njejtën punë. Madje ka shkelje edhe në pagesë, ato ekzekutohen nga një kod buxhetor në një tjetër, e tjera.

**Aziz Bici** - Raporti i Zyres Kombëtare të Auditimit për vitin financiar 2020, prapë ka theksuar parregullësi dhe vërejtje të shumta në aspekte të ndryshme. Pika a, mosverifikimi i pronave të regjistruara ku prej 6,428 pronave të regjistruara gjatë vitit 2020, keni bërë inspektimin e vetëm 240 pronave, që do të thotë se janë realizuar vetëm 3.7 %. Nën b, mospagesa e taksës për ushtrimin e veprimtarisë, parregullësi të planifikimeve të zhvillimit të procedurave të Prokurimit, të tilla si blerja e softverëve financiar në vlerën prej 8,900 €, nuk ishte e planifikur në planin vjetor të Prokurimit, as nuk ishte njoftuar AQF-ja, për këtë procedurë të Prokurimit. Mandej, njejtë është vepruar edhe në kontratën për furnizim me pajisje për institucionet shkollore në vlerën prej 33,436 €, pranimi i çertifikatave të lëshuara nga vendet e huaja, por të pa nostifikuara, kontrata publike kornizë për furnizim me material mjekësor në vlerën prej 169,380 €, ku ishte planifikuar për furnizim me 200 copë të produkteve, e sipas evidencës të menaxherit të kontratës, ishin furnizuar me 4,100 copë, duke kaluar limitin për 30 %. Ndarja jo e duhur e detyrave, parregullësi në menaxhimin e Kontratave, mospërgatitja e planit vjetor për mbështetje financiare për subvencionim, parregullësi në procesin e subvencionimit të OJQ-ve, për të cilat në vazhdimësi në LVV, kemi reaguar tashmë veç janë të faktuara nga Zyra e Auditimit.

**Kryesuesi** – Ju njoftoj se në mbledhjen e KPF-së, e kemi debatuar raportin dhe kemi nxjerrë një konstatim se raporti është i pakualifikuar dhe është pa theksime të mëdha të çështjeve, që do të thotë se është brenda kornizës administrative ligjore që ka mund me funksionue. Drejtoresha e financave, e ka sjellë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga raporti i auditimit për Komunën e Obiliqit, për vitin financiar 2020. Tani, hapi debatin nëse, dikush ka diçka për të thënë, e nëse jo, atëherë kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

#### **Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Juve, iu ka ardhë me material raporti financiar janar-qershor 2021, i Kryetarit të Komunës, që besoj se e keni lexuar dhe tash e hap debatin për këtë çështje.

**Lulzim Sadiku** – Te raporti i punës së Kryetarit për 6 mujorin e këtij viti ka një përshkrim pothuajse të njejtë dhe është aktivitet krejtë rutinor që janë përditshmëri. Pra, po bëhet një raport me sa e sa faqe, që në fakt jam bindës se unë nuk e kam lexuar 70 % dhe nuk dua të paragjykoj te të tjerët. Ajo që bie në sy dhe është esenciale është raporti i DEFZH-së, ku vërehet nga raporti një shkallë e ulët e inkasimit dhe unë e kuptoj që për shkak të covidit, kjo nuk ka mund të bëhet. Te të hyrat vetanake, aq më pak kur dihet mjetet e shumta që vijnë nga KEK-u, tashmë besoj se janë inkasuar. Sipas të gjitha gjasave nga ky trend i inkasimit të të hyrave vetanake edhe këtë vit sikurse në vitin e kaluar Komuna, nuk mund të arrijë të planifikoj planifikimin që e ka bërë vetë, do të thotë të mendoj se do të ketë suficit. Po ashtu, vërehet një shkallë tepër e ulët të shpenzimet e buxhetit, sidomos në linjën e investimeve kapitale që sjellë një konstatim që është kësaj here si në vitin e kaluar. Komuna do të ketë shumë mjete suficit dhe kjo është vërtetë keq.

**Kryesuesi** – Në mbledhjen e KPF-së, është debatuar për raportin 6 mujor dhe duke pasë parasysh se është vit pandemik viti 2020 dhe 2021, mendoj se Ekzekutivi ka bërë një punë të jashtëzakonshme në mbledhjen dhe shpërndarjen sa më të drejtë të taksave të qytetarëve.

#### **Pika 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqet kërkesën e DEFZH-së, për anulimin e vendimi nr.-I-103, nga mbledhja e kaluar dhe marrjen e vendimit tjetër për transfer dhe rialokim të mjeteve.

**Zarife Behluli**– Ne në muajin e kaluar kemi marrë vendim për transfer dhe rialokim të mjeteve, por në përqindjen 14.99 %, janë eliminuar të hyrat e bartura nga viti 2020 në vitin 2021 dhe i kemi vetëm këto ndryshime:

- Te asfaltimi i rrugëve zvoglohet vlera për 4,391.97€, ndërsa te rialokimi laboratorit mobil në projektin brenda Drejtorisë rregullimi i parqeve në Komunën e Obiliqit 3,406.44 €, nga kjo vlerë 2,631.29 €, janë rritë te parqet nga vlera e kaluar, ndërsa 775.15 €, është zvoglimi i vlerës në përqindje nga të hyrat e bartura. Këtu, janë heqë vetëm të hyrat e bartura të DSHPE-ja dhe te ndryshimi i rialokimit të DMM-ja.

- Te asfaltimi i rrugëve rurale dhe trotuareve, tani vlera mbetet 209,745.21 €, rregullimi i kanalizimit nuk ndryshon, shpenzimet komunale në mallra nuk ndryshojnë, transferi total është 325,304.54 €, ndërsa rialokimi te rregullimi i parqeve është 176,576 €, që do të thotë në total transferi dhe rialokimi janë 501,881.03. Unë kërkoj falje që kanë ndodhë këto, por në vitin e kaluar i kemi bërë me përqindje ndërsa këtë herë e dërgova kërkesën në Ministrinë e financave dhe ata e kthyen me përgjegje se hiqen të hyrat vetanake dhe përqindja mbetet vetëm me buxhetin e vitit 2021.

**Lulzim Sadiku** – Pyeti se mjetet në vlerën mbi 501 mijë €, a mbeten prapë suficit, i shtohen mjeteve prej 1 milionë e 800,000 €.

**Zarife Behluli** –Përgjegjet se transferi i mjeteve bëhet nga DSHPE-ja, dhe besoj se këtë material e keni. Nga vlera e ambullantave kanë mbetë nga projekti 825 €, pajisje mjekësore për QKMF 10.575 €, nga të hyrat vetanake që është kryer pagesa. Nga digjitalizimi i rrugëve 6,782 €, është mbyllë kontrata dhe nga renovimi i banesave sociale 72,778.73 €, është mbyllë kontrata. Ndërtimi i objekteve, renovimi i hapësirave për komunitetin, kontratat që janë duke u punue i kanë mjetet e veta dhe pjesa që ka mund me mbetë me humbë ka qenë 35,560.97 €, që këto mjete në mbyllje të kontratave 209,745.21 €, shkojnë në asfaltim të rrugëve rurale dhe trotuareve sepse janë projekte që presin të realizohen. Laboratori mobil ka pasë probleme me OSHP-në, dhe ne jemi detyruar me rishikue këtë projekt në mënyrë që të shfrytëzohen këto mjete me u bërë punë brenda këtij viti dhe me u shpenzue. Prej laboratorit mobil 83,223.81 €, shkojnë te rrugët ndërsa pjesa tjetër në atë 350,000 €,shkon rregullimi i parqeve në Komunën e Obiliqit. Total transferi dhe rialokimi bën 501.881 €, që ne presim me u krye punë brenda këtij viti.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 11 vota për e aprovuan anulimin e vendimit nr.-I-103, të dt.04.08.2021.për transfere dhe rialokim të mjeteve për vitin 2021.**

Dhe

**me 12 vota për e aprovuan Vendimin për transfere dhe rialom të mjeteve për vitin 2021.**

**Pika 6 e rendit të ditës**

**Kryesuesi**– Paraqet raportin e DKA-së, duke e falenderuar DKA-në, për korrektësinë dhe Komisionin i cili e ka përpiluar raportin.

**Lulzim Sadiku** – Unë raportin e Arsimit e kam shikue sipërfaqësisht dhe e kam pare te çështja e zgjedhjes së drejtorëve, te çështja e mungesave, te çështja e pranimit, të gjitha gjërat që në fakt i duhen një raporti. Diçka që i ka mungue këtij raporti ka qenë profili i mësimdhënësve.

**Kryesuesi** – Z,Lulzim mos dilni jashtë temës sepse ky është raporti i DKA-së dhe ne raportin e Kryetarit e përfunduar më heret.

**Lulzim Sadiku** - Ne kemi probleme me gjuhë të huaja sepse te profili kur po kërkohet drejtori i shkollës, është i obliguar që ta din edhe gjuhën angleze. Shumë drejtorë që kanë shumë suksese të mëdha si znj.Shyhrete Gashi, që e njeh gjuhën angleze, unë kërkoj që në të ardhmen me qenë rregullë që drejtori i shkollës ta dijë gjuhën angleze. Unë nuk dola jashtë temës, por isha taman në temë dhe për këtë kërkoj falje.

**Kryesuesi** – Besoj se një pjesë e drejtorëve e njohin gjuhën angleze, frënge, gjermane dhe këta janë drejtorët më të mirë të mundshëm që i kemi.

**Pika 7 e rendit të ditës**

**Kryesuesi**– Paraqet kërkesën e Komisionit komunal të aksionarëve nga drejtori i DSHPE-së, për ndarjen e mjeteve financiare për N.P.L.Kastrioti SH.A.

**Anëtarët e Kuvendit komunal me 14 vota për e aprovuan Vendimin për ndarjen e mjeteve financiare në vlerën prej 25,000 €, për N.P.L. Kastrioti SH.A.**

**Kryesuesi** – Ju njoftoj se kërkesa që iu rekomandua Zyres së Kryetarit dhe DEFZH-së, për shqyrtim në mbledhjen e KPF-së, është kërkesa e Nazmi Smajlit, OVL-UÇK, dega në Obiliq. Ne presim që në mbledhjen e radhës lidhur me këtë kërkesë të na njoftojnë.

#### **Pika 8 e rendit të ditës**

**Aziz Bici** – Së pari, po flas për parkun në fshatin Mazgit i Epërm dhe ju e dini se në pranverë ju kam komplimentuar për mirëmbajtjen dhe ndërtimin e sheshit. Mirëpo, sot për fat të keq dua të ju tregoj se ai park është tharë komplet dhe dikund 70 %, e drunjve janë tharë, dijeni se nuk është duke u mirëmbajtur. Në rast se mendoni me ndërtue parqe dhe me i lënë vetëm kur bie shi, atëherë më mirë është mos i ndërtoni fare. Ju e dini se atje, është çelë edhe një pus, që është dashur me i ujitë, është dashur me mirëmbajtë sepse vërtetë komuniteti i fshatit Mazgit, e ka shfrytëzue dhe e ka rue, por edhe ju duhet me i krye obligimet e juaja.

**Kryesuesi** – Unë nuk mund ta marrë detyrën dhe përgjegjësinë e Ekzekutuvit, por mund ta them një gjë sa i përket parkut në Mazgit të lartë për këtë arsye është themeluar Ndërmarrja Publike Lokale “Kastrioti” e cila do ta ketë mirëmbajtjen maksimale.

**Hysni Mjeku** – Mbi të gjitha unë e kam një kërkesë, te parku në fshatin Grabofc i Epërm, në lagjen e Haxhi Hasanit, a janë zotue mjetet dhe kur do të filloj ky park sepse punimet kanë ngecë dhe arsyetja pse kanë ngecë.

**Aziz Bici** - Ju e dini se para 2 seancave, me kërkesë nga opozita është premtime ofrimi i një raporti, i procesverbaleve të punës së Komisionit për ndarjen e banesave të Hades. Unë sot kërkoj që të na tregoni se a do të na sjellni pasi që keni premtime, apo nuk do të na sjellni fare. Prandaj kishte me qenë mirë që sot me na tregue.

**Kryesuesi** – Për çdo pyetje që sot drejtorët nuk mund të japin përgjegje e keni obligim së paku që të na njoftoni në mbledhjen e radhës.

**Armend Rushiti** – Pyetja ime ndërlidhet me pyetjen e z.Aziz Bicit, lidhur me atë Komision që Kryetari, u zotue vet se do të na sjellë punën e atij Komisioni. Tash, Kryetari nuk është prezentë dhe as në mbledhjen e kaluar nuk ka qenë prezentë, por ai është zotue se ka me sjellë atë raport. Në mbledhjen e kaluar veç është bërë ndërrimi i atij Komisioni, por pa procesverbal sepse ne nuk e dimë se çka ka ndodhë në atë Komision. Pyetja ime është e njejtë sikurse e z.Aziz Bici. Edhe një pyetje e kam për fshatin Bakshi, se çka u bë me tokenë që 4 vite u përfolë, jo po ndërrohet, jo nuk po ndërrohet dhe asnjë projekt nuk ka fillue me u krye, më se 90 %, të projekteve në fshatin Bakshi, nuk janë realizue.

**Nora Preniqi** – Unë deshta të bëjë një pyetje për rrugën “Halit Bici” në Mazgit, pjesa anësore e kësaj rruge është betonue për shkak se në një pjesë kanë kalue ujërat e shiut pasi, që është ndërtuar autostrada dhe aty është ndarë si me kufi te disa bashkëvendas të mi aty. Dua të di se a është në plan për përfundim, apo do të mbetet te anëtarët e juaj që iu mbështesin.

**Lulzim Sadiku** – Unë dua ta bëjë një pyetje për gurëthyesin në fshatin Sibofc, se para pak ditësh ishte një protestë bukur e madhe atje, një shqetësim shumë i madh i banorëve. Edhe Ministria përkatëse ka lëshue një vendim në kuadër të gjitha Komunave, për të gjithë gurëthyesit dhe ju a po e zbatoni që vërtetë mos me vazhdue punën, apo duhet të ndodh diçka për ta ndaluar punën në fshatin Sibofc, me atë gurëthyes.

**Nazmi Gashi** – Unë i kam përcjellë dhe shumë prej juve jeni futur prapë në konkurrencë dhe nuk ka qenë mirë me na ngushtue sepse do të ishim mbetur 4 vjet shokë të mirë. Tash, nuk po din njeriu kujt me ia dhënë votën, megjithatë ata që janë le ta vazhdojnë, ndërsa ne të moshuarit ngadalë do të tërhiqemi që të iu japim mundësinë njerëzve të cilët e kanë përspektivën. Kaluan 4 vite, me sqarime e shpjegime dhe ndonjëherë nuk kemi marrë përgjegjet e kërkuara, por rrethanat kanë qenë të tilla. Unë kam mbetë mangut për fshatin Sibofc, kësaj here më shumë kam shkue në Sibofc dhe po takohem me qytetarë atje, prandaj janë disa

kërkesa që DPUKP-ja, nuk ka mund me na dhënë përgjegje bile të përafërt. Krejtë çka është brenda shtetit është zonë e interesit të shtetit, prandaj zonë e interesit specifike janë fshatrat dhe lokalitetet që janë futë për minjera prapë. Mirëpo, në zonën e interesit janë disa shpjegime se cilat veprime nuk mund të bëhen në atë zonë të interesit. Ne kemi debatuar dhe kemi thënë se për 40, ose 60 vite, nuk do të ketë depërtim të KEK-ut, në këto hapësira për eksploatim. Inspektorët po dalin, presioni po shtohet dhe qytetarët janë mjaft konfuz. Prandaj është mirë që ne ti marrim disa vendime, ose ne, ose ata që vijnë pas neve që me ua sqarue njerëzve se çka mund të bëjnë aty.

**Armend Rushiti** – Dua të di prej drejtorit të DSHPE-së, nëse ka mundësi të ketë një bashkëpunim me Komunën e Prishtinës lidhur me ujërat e zeza që derdhen në fshatin Bakshi, në tokat bujqësore dhe në përrockën e fshatit. Pyes se me çfarë logjike është bërë ky farë bashkëpunimi nonsens, çfarë përfitimi ka Komuna e Obiliqit nga ky bashkëpunim.

**Lulzim Bllaca** – Unë dua të pyes rreth bregut të lartë që po i thojnë ata dhe banorët problemin e kanë me ujë sepse nuk ka shtypje. Prandaj, si ka mundësi me bashkëpunue me kompaninë e ujësjellësit për me iu bë një zgjidhje atyre që edhe ata të kenë ujë të mjaftueshëm. Këtë problem ata e kanë që disa vite dhe nuk është bërë ndonjë zgjidhje në këtë drejtim. Unë nuk besoj se është fjala për keqpërdorim të ujit, por besoj se mund të ketë një zgjidhje.

**Hysni Mjeku** – Unë e kam një pyetje ura e Plemetit, është ndërtuar fjala është për segmentin e rrugës që lidhet nga fshati Hamidi, deri te shkolla, do të thotë kalon në lagjen e Sadikajve dhe shkon deri te Hotët, aty në qysh. Unë kam kaluar para 3 jave, por vërtetë është tmerr. Pyes kur pritet kjo rrugë të ndërtohet dhe asfaltohet sepse po ia humbë hijeshinë edhe urës në Plemetin.

**Ilire Kelmendi Shema** – I përgjegjem z.Lulzim Sadiku, për çështjen e gurëthyesit sepse në takim me Kryetarin e Komunës dhe Bordin e drejtorëve, duke marrë parasysh se i përket Drejtorisë së kulturës pjesë e trashëgimisë së kulturës maja e zezë, unë kam dërguar disa emaila në MKRS dhe Institutin arkeologjik të Kosovës. Emailat janë kthye dhe jemi në procese për të dalë bashkë me gjeodetin dhe sigurisht se brenda 2 jave, do të jemi të gatshëm të shkojmë atje. Gurëthyesit veç iu kanë ndaluar punët dhe ai nganjëherë punon ilegalisht, por nga inspektoriat i Komunës, i është ndaluar puna. Gjithçka është nën kontroll sepse unë vijë nga ajo fushë e trashëgimisë dhe me prejardhje jam nga fshati Sibofc, jam pjesë me qytetarët e Grabofcit, Shipitullës dhe Sibofcit, prandaj shpresoj se në të mirë do të ndalohet i tërë procesi i gurëthyesit në Sibofc.

**Dragan Dancetovic** – Ponovio bih problem o kojima sam vec pricao, koji nazalost jos nisu reseni. Jedan od problema je na samom ulazu u selu Babin Most, gde voda iz kanalizacije sakte islazi i preliiva ulicu. Taj problem traje duze od 4 meseca, i ja molim nadleznu Direkciju, i molim vas da nastupite u kontakt sa ljudima iz Ibar - Lepenca, posto je delom ta voda iz kanala Ibar – Lepenac, da se taj problem sto pre resi. Ta voda tece non-stop, vec 4 meseca, i pravi problem nama, i pravi nam problem nama sto zivimo u tom delu, pravi problem ljudima koji idu pesice, ne mogu da prodju a da ne pokvasu noge. Bila je sezona kada mnogo ljudi sa strane dolazili gradjana sa inostranstva, i mislim da je to mnogo ruzna slika da kao jednostavan problem ovako dugo da se ne resi, i zato ocekujem od nadlezne Direkcije i od Ibar-Lepenca, da se taj problem sto pre resi. Drugi problem je vezan za snabdevanje pijacem vodom, instalacija postoji, cevi postoje i mi smo zainteresovani da potpisemo ugovore sa vodovodom da platimo ono sto potrosimo, ali da imamo zdravu pijacu vodu. U tom smislu bih zamolio da Opstina pomogne. Trece pitanje je da projekti su vec uradjeni za uredjenje sporedne ulice u Babinom Mostu, bilo je raspolozenja i dobre volje da se urade tih putevi, medjutim stalo se sa tim, i ja sada postavljam pitanje, da li ce do kraja godine tih putevi biti uradjeni.

**Armend Rushiti** – Është e palogjikshme me thënë drejtoresha se ndonjëherë ata punojnë ilegalisht, por a ka denime për ata, a i kontrollon dikush sepse ai është gurëthyes dhe nuk është duke luajtur shah që mos me u dëgjue zhurma.

**Kryesuesi** – Sa i përket furnizimit me ujë të pijes është bazë elementare që sipas LVL-së, është kompetencë themelore e Komunës. Unë ju lus me planifikimin buxhetor që bëhet këtë vit për vitin e ardhshëm të ketë një kod të veçantë trajtimi i ujit të pijes sepse mbi 95 % banorët e Komunës furnizohen me ujë të pijes me

përfundim të fshatit Graboc. Ne duhet të bashkëpunojmë me kompaninë KUR "Prishtina" që me të zgjidhjen e Grabocit të Epërm dhe të Poshtëm përmes fabrikës së re dhe gjithë këto investime që ne duhet ti bëjmë përmes rrjeteve dhe mirëmbajtjeve. Besoj se për pyetjet e ngritura do të merrni përgjegje në mbledhjen e radhës.

**Armend Rushiti** – Qysh nuk ka përgjegje që 4 vjet, ujërat e zeza derdhen prej Prishtinës në fshatin Bakshi dhe për 4 vjet nuk janë zgjidhë problemet, e po zgjidhen për një seancë. Pyes për 4 vjet çka ka bërë DSHPEja, për këtë çështje.

**Kryesuesi** – Sqaron se pa u bërë në nivel të regjionit trajtimi i ujërave të zeza, të lumenjve që kalojnë nëpër Komunën tonë, kjo nuk mund të rregullohet. Besoj se vendimi i Qeverisë së Kosovës në vitin 2018-2019, për ndarjen e 60 milionë eurove, për ndërtimin e 2 impianteve për trajtimin e ujërave të zeza, derisa kjo të bëhet ka me qenë problem.

**Mbledhja përfundoi në ora 11:15'**

**Bashk.prof.për punë të KK**

  
Azize Zeneli



**Kryesuesi i Kuvendit Komunal**

  
Burim Gërguri